



KUVENDI KOMUNAL - DEÇAN

Municipal Assembly of Decan

TRANSKRIPTI

DECANI

Mbledhjen e Kuvendit të Komunës

(Legjislatura e VII , mbledhja e VI) me dt.31.07.2025



DEÇAN

e Enjte, 31 Korrik 2025

Hajdar Sutaj

Kryetar Bashkim Ramosaj, kolegë anëtarë të Kuvendit Komunal, përfaqesues të OSBE-së, e hapi takimin e gjashtë të rregullt të Kuvendit Komunal të Deçanit për vitin 2025 edhe për rend të dites propozoj:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i transkripteve nga dy mbledhjet e kaluara,
2. Raporti gjashtëmujor i Kryetarit të Komunës,
3. Shqyrtimi i raportit të tre mujorit të dytë financiar,
4. Shqyrtimi i raportit të Auditorit të Jashtëm për vitin 2024 dhe Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit,
5. Shqyrtimi i Raportit gjashtë mujor të Zyrës për Barazi Gjinore,
6. Raporti i KKSBB-së,
7. Shqyrtimi dhe miratimi i Draft-Rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës në administratën komunale,
8. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave (PNMIM) për pesë komunat e rajonit të Dukagjinit: Pejë, Klinë, Istog, Deçan dhe Junik (materialin e kini nga mbledhja e kaluar),
9. Marrja e vendimit për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë 30,000.00 euro për Memorandumin e Mirëkuptimit ndërmjet Komunës së Deçanit, NPL “Higjiena” dhe Fondacionit CNVP, për instalimin e sistemit të ngrohjes qendrore me bazë biomasën,
10. Formimi i Komisionit për ndarjen e bursave për studentë dhe Komisionit të ankesave në procesin e ndarjes së bursave për studentë,
11. Të ndryshme.

Për zbatimin e rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit.

Grupi i AAK-se, Arian Dobraj e ka fjalën. Florim Mataj, para se me marrë fjalën Florim Mataj, fillimisht do e kalojmë fjalën te drejtoresha për buxhet dhe financa Dafina Cacaj që të thotë fjalën hyrëse.

Dafina Cacaj

Përsëritet edhe një herë për të gjithë. Raporti i auditimit për vitin 2024 ka ardhë muajin e kaluar dhe sipas planit që e kemi pasur këtë muaj edhe është ardhë në Asamble, e kemi përgatitur edhe planin e zbatimit të rekomandimeve. Komuna e Deçanit vitin e kaluar ka pasur 12-të rekomandime. Gjatë vitit 2024 kemi arritur me i përmirësu gjashtë rekomandime. Pesë rekomandime janë mbetë të papërmirësime, ndërsa njëra është gjysmë e përmirësime edhe një është për rekomandim të ri. Po de gjashtë edhe një i ri shtatë, se gjashtë janë mbet vjetsh, po njona është gjysë-gjysë. Ndërsa tek këto rekomandime, të cilat kanë mbetur shumica janë teknike. Unë jam shumë, s'po thom e lumtur, po mirëniha, kur nuk kemi rekomandime të cilat çojnë në dyshime të mëdha, sikur ka pasur nashta në komunat tjera. Nënshkrimi i kontratave njëburimore ose keqpërdorimet e parasë publike. Në raportin e Auditorit për vitin 2024, Komuna e Deçanit nuk pasqyron asnjë shkelje edhe nuk ka rekomandime të kategorisë rëndë. Një kategori që mundën mu përmirësu lehtë për shkak se shumica janë teknike. Rekomandimi i parë i cili edhe është i ri ka qenë, siç ju thashë edhe më herët për përmbarimet, të cilat pagesat që janë be në kategorinë e kapitaleve, Komuna e Deçanit nuk i ka regjistruar si pasuri, për shkak se unë nuk kam pasur djeni që duhet mu regjistru si pasuri gjatë vitit, për shkak se unë i terheki vetem fund vitit për pasqyra financiare. Edhe pse ato mjetet nuk janë marre vetëm për kapitale, kanë mujt mu marrë edhe për pjesë, për tjetër gjo sikur janë mallera shërbime ose për shujtat. Mirëpo, e kom bo ankesën, po Zyra Kombetare e Auditimit nuk e ka vlerësu që e kom me drejt edhe e ka paraqitë prap se

prap. Ndërsa pesë rekomandime, gjashtë rekomandimet tjera që janë të vjetra, tri janë që kanë të bëjnë me tatimin pronë. Te tatimi i pronës kemi pasë një defekt, sepse kemi staf të pa mjaftueshëm. Kemi provu me marrë zyrтарin për mbledhjen detyrueshme, mirëpo që ka dashtu në ankesa dhe kemi mbetë pa zyrтар. E kemi pasë mungesë automjeti, tash veç e kemi një automjet edhe besoj që shumë shpejt bazë, kur të përfundon edhe rregulloria për sistematizimin e vendeve punës me mujt mi marrë dhe dy anketues, të cilët parashihi, sepse u dal në pension zyrтарi dhe ende skem mujt me zavendësu, që me mujt me u përmirësu edhe te llogarite e arkëtushme edhe te njezet përqindeshi, që osht i pa i pa rregullum. Këtë gjysmë viti jom tu u munu që jom përkushtu për tatimin pronë që me mujt mu rregullu disa. Ndërsa rekomandime të tjera janë sipas planit rekomandime, sipas planit zbatimit që e kemi paraqitë, duke u munduar që ti zbatojmë deri në fund vitit. Për rekomandimin e parë veç e kom bo kërkesën thesare dhe besoj që brenda dy muajve do tregullohet ajo, sepse është diçka që kemi mujt me e bo pa pas nevojë për rekomandim. Mirpo kur nuk e ki nashta dijen e mjaftueshme, munesh me gabu edhe sepse pasuritë veç janë të regjistruara në sistem, janë të paraqitura në raport. Pasqyra financiare Vlera e pasurisë së komunës së Deçanit veç dihet është gjashtedhjetë e kater milionë edhe qysh ka qenë e paraqitur në raportet e tjera të auditorit. Tashmë nuk oshtë. Osht vetem kjo që 280 mijë që ka qenë diferenca që nuk e mujt me regjistru në sistem te pasurive. Unë nuk kam diçka me shtu, nëse ju kini me bo pyetje, muna me u përgjigj aq sa dije. Faleminderit.

Hajdar Sutaj

Falemnderit shum, fjalën e ka Florim Mataj, ne emer te grupit te AAK-se. Veç afro mikrofonin, të lutna per shkak të...

Florim Mataj

Përsëndetje Kryesues drejtor, koleg asambleista, shoqëri civile. Meqenëse po flasim për Raportin Auditorit pasqyra financiare vjetore te komunes se Deçanit për vitin 2024. Lajmi i mirë është, është opinion i kualifikuar. Ndoshta ka përmesimën nga vitit ne vit. Meqenëse e kemi diskutu me drejtoreshën edhe në Komision Politikë e Financa, e dha, e dha një arsyshmeri drejtoresha. Unë ndoshta kisha kërkuar që edhe publikisht nga drejtoresha këtu, që për vitin, vitin që vjen ta kemi ni raport meqenëse e cek edhe ma herët janë shumica janë probleme administrative ndoshta që munen mu zgjidh. Kështu që po du me shpresu që vitin që vjen ta kemi ni raport të kompletuar 100%. Ju falënderoj për punën dhe përmesimin e raportit të auditorit ndër vite. Eshte viti i tetë që jam këtu, ndoshta ka disa qe i ceke, shembull regjistrimi i pasurisë e disa probleme tjera ndër vite, si po na percillin. Kështu që nuk është ne j diçka unë mendoj më shumë është, ndoshta s'dua me e quajt një neglizhencë, por një aspekt administrativ që osht nje diçka që nuk duhet me na ndodh. Ju pergezoj drejtoreshë, kaq kisha.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Florim! Ne emer te grupit të LDK-së. Blinera Lokaj.

Blinera Lokaj

Faleminderit kryesues! Përsëndetje per te gjithë, Pra, sot po e shqyrtojmë raportin e auditorit, si një nga dokumentet më të rëndësishme për komunën tonë. Është hera e pestë, për gjatë këtij mandati që ne e diskutojmë këtë raport dhe fatkeqësisht vit pas viti po na vije me opinion të kualifikuar. Unë po ndalem vetëm pak tek çështja, Mungesa e stafit dhe

planeve të veprimit në adresimin e rekomandimeve të Njesisë së Auditimit të Brendshëm. Rregullorja për themelimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm përcakton qartë, që komunat që kanë buxhet vjetor mbi shtatë miliona euro, duhet të kenë se paku tre auditor. Ndërkaq, Komuna e Deçanit operon vetëm me një drejtor dhe me një anëtar. Rrjedhimisht, mungesa e stafit në Njësine e Auditimit të Brendshëm po ndikon, drejtpërsëdrejti në efikasitetin e kësaj njësie. Po ashtu po ndikon edhe në monitorimin e brendshëm të financave publike. Andaj, ne i bëjmë thirrje menaxhmentit që të marrë masa konkrete për, plotesimjen e kapaciteteve njerëzore në Njësine e Auditimit të Brendshëm, pra të plotesohet me staf te mjaftueshm sipas rregullorës. Po ashtu, drejtoritë përkatëse duhet t'i analizojnë me kujdes dhe me seriozitet të gjeturat e auditorit, dhe të hartojnë një plan konkret për adresimin e rekomandimeve. Përndryshe, opinioni i kualifikuar, i shkakton dëme komunës sonë. Sipas këtij raporti, komuna e Deçanit sërish përjashtohet nga pjesëmarrja në grantin e performancës, e cila është një mundësi e mirë, që komuna të përfitojë fonde për financimin e projekteve të tyre. Po ashtu, granti i performancës nuk duhet te shikohet vetëm si një shpërblim financiar apo monetar, por ajo është edhe pasqyrë e nivelit të menaxhimit, transparencës dhe zbatimit të ligjshmërisë mbi shpenzimin e paras publike. Faleminderit.

Hajdar Sutaj

Blinera, të faleminderit.

Hajdar Sutaj

Prej vetëvendosjes? Orgesi ka fjalën.

Orges Tafilaj

Falemnderit kryesues. Fillimisht përgëzime për përmirësimin e raportit lidhje ose krahasuar me vite të tjera. Çka mbetet shqetësuese akoma edhe që është vështirë e përmirësueshme janë vendimet gjyqësore, për shkak të obligimeve që ka komuna dhe efektit zinxhirore që e përmendëm edhe më herët. Pajtohna me Blinerën që vrejta që është dhënë për auditorin shtesë, është e përmirësueshme dhe koordinim me kryetarin besoj që për herën tjetër kjo vetëm duhet të përmirësohet. Te regjistrimi i pasurive, tashmë meqenëse e përmende, ka përfunduar si opsion i tillë edhe është mirë. Pagesat brenda afatit 30 ditorë, e thamë edhe më herët kur shqyrtum raportin paraprak, që është mirë t'ju kushtohet vëmendje edhe mos të mberrijë që të tejkalohet edhe të kenë kosto shtesë. Pesë rekomandime që nuk janë zbatuar, disa prej tyre prapë është problem të zbatohen, po disa që i përmendëm është mirë të zbatohen edhe raporti i ardhshëm, te vijë edhe më i mirë, e pse jo të ndërroj edhe ky opinionin e vetë, në mënyrë që komuna jonë të jetë pjesë e Grantit të Performancës, dhe të fitojë fonde shtesë që mund të përdoren në te mirë të qytetarëve. Faleminderit!

Hajdar Sutaj

Te falënderoj shume, z.Tafilaj, z. Mon Selmanaj e ka fjalën, nga Rradha e Partisë Demokratike të Kosovës.

Mon Selmanaj

Faleminderit kryesues. Mendoj se mungesa e kryetarit për trajtimin e kësaj pike është e pajustificueshme sot, megjithatë ne po vazhdojmë me trajtimin e saj. Edhe për vitin 2024, auditori ka dhënë opinion të kualifikuar pra jo të mirë, për pasqyrat financiare vjetore me theksim te disa çështje. Pra, vazhdon avazi

vjetër me menaxhimin jo të mirë, pa transparencë dhe llogaridhënie. Pra, baza për këtë opinion është pasaktësia e plotë e shpalosjes së pasurive financiare e ato ishin nenvlerësuar prej, për 965,276 euro. Ndërsa te baza konkluzion për pajtueshmëri janë: mosverifikimi i 20% të gjendjes aktuale të objekteve, dy, vonesa ne pagesen e faturave dhe shpenzimeve tjera shtesë për pagesat e ekzekutura nga thesari. Tre, emërimi dhe angazhimi i zyrtarëve për kryerjen e shërbimeve veçanta jo në pajtueshmëri me ligjet dhe rregullat e zbatueshme. Nga të gjeturat, auditori ka dhënë edhe rekomandime si: përmirësimi në menaxhimin e pasurive të hyrat, llogaritë e arkëtueshme, pagesat e faturave brenda fateve ligjore, menaxhimin e personelin, verifikimin e objekteve për tatimin ne pronë dhe auditimi i brendshëm. Tek të gjeturat, që ndikojnë në opinionin e auditimit janë: 1: është vërejtur se pasuritë jo financiare kapitale nuk janë regjistruar plotësisht në regjistrat përkatëse të **SIMFKS-se**. Në këtë sistem mungon regjistrimi i blerjeve kapitale për vitin 2024, në vlerën 965,276 euro. Përveç saj, nuk është bërë vlerësimi i projektit për renovimin në zyre në objekte komunale, investim ky në vlerë 52,765 euro. Te mos verifikimi i 20% të objekteve, auditori konstaton që në krahasim me vitin paraprakë kemi një ulje për rreth 7%. Të gjeturat me vonesen e pagesave të faturave dhe shpenzimeve shtesë, auditori ka vërejtur në pesë raste të pagesave, të cilave iu ka kaluar afati ligjor 30 ditësh, në shumë prej 108,791 euro. Ndërsa nga analiza e raportit të shpenzimeve ka vërejt se përmes vendimeve gjyqësore përmbartimore ishin paguar u perserit disa her 4 milion e 388 mijë e 918 euro nga kategoritë Paga, mallra dhe Shërbime Komunali etj. Vetëm për një rast është aplikuar interesi me kamate vonese në vlerën prej 2,937 euro. Unë dhe disa kolegë këtu, disa here e kemi ngritur si shqetësim kontraktimin e punëve pa pasur buxhet mjaftueshëm dhe kjo na ka sjellë te vendimet gjyqësore përmbartimore dhe rritja e kostos për komunën. Të gjetura të tjera për angazhim e zyretareve për shërbime te veqanta ku 33 punëtorë kishin vendime për kohe të caktuar nga gjashtë deri në dymbëdhjetë muj, ndërsa dhjetë prej tyre vazhdojnë ende të jenë në vitin 2025. Kjo dëshmon se komuna ka vepruar pa procedura dhe/ne kundërshtim me ligjin ne fuqi. Të nderuar kolegë, duke përfunduar këtë diskutim mbi kete raport me letër konfirmimin e kryetarit të komunës për pajtimin e tij me të gjeturat dhe rekomandimet e auditorit, si dhe zotimi se do të hartohet një plan veprimi për zbatimin e tyre, uroj që vitin e ardhshëm Kuvendi me përbërje të re dhe me kryetar të ri të ketë sa më pak ose aspak punë në trajtimin e raporteve të tilla. Ju falimnderit.

Hajdar Sutaj

Me lejoni që me konsideratën time më të lartë, e të shpreh vlerësimin maksimal për kontributin e kolegut tonë, zotrit Mon Selmanaj edhe për fjalën që mbajti. Te falenderoj shume. Kush është për fjalë? Ju kisha lutur që të jeni sa më konkret në diskutimet e juve dhe përmbajtësore. Urdhero Albesa Cacaj.

Albesa Cacaj

Atëherë përshëndetje edhe një herë! Sa i përket raportit të auditimit për pasqyrat financiare, krejt çka dua me thanë është për opinionin publik. Se besoj që të gjithë ne kemi raportin, e kemi lexuar dhe e kemi shqyrtu. Të dashur kolegë, të respektuar qytetarë! Nuk besoj që ka vend për përgazime. Opinioni i kualifikuar nuk është për përgezim. Sikur komuna e Deçanit kish marrë opinion te pamodifikuar, atëherë edhe ne, si LDK besoj kejt opozita, e krejt qytetarët ishin gëzu, sepse të mirat edhe të kqijat i jetojmë edhe pasqyrohen në vendin ku ne jetojmë. Për hirë të transparencës dhe meqenëse shumë qytetarë na ndjekin, po du me me qartësu ata çka osht shkru n'ket raport. Kur merr komuna opinion te kualifikuar? Opinioni i kualifikuar formulohet kur janë zbulu keq deklarime dhe ose mospajtueshmëri, qoftë një vetem apo një grumbull që janë të barabartë me ose tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi ose kur keqdeklarimi dhe ose mos pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë transaksioneve. Formulohet gjithashtu nese ka kufizim të fuqiveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangje të keq deklarimeve materiale. Edhe këtu duhet mu pajtu se po, është e vërtetë se rekomandimet janë zbritur nga viti 2023 ku janë kon gjithseje trembëdhjetë katërmëdhjetë, po te opinionin vit mbas viti është i njëjti. Domethënë nuk ka vend për përgazime. Nuk du mu lshu në detaje,

cilat edhe kolegët parafalës i, i konstatuan. Thjeshtë du mu lshu te deklarimi publik i drejtoreshes, e cila u deklarë në një nga seancat publike që kur u bo pyetja, a keni ndërmarr veprime që opinionin e vitit të ardhshëm do te jetë i paster për komunën e Deçanit? Ajo ka thonë publikisht që deklarona se opinionin ka me konë maj mirë se vitit kalim. Pyetja që du mi shtru, cila është përgjegjëse edhe pse e kom shtru këtë kërkesë ose pyetje dy tre herë në vazhdimësi. Përveç raportit të auditimit, osht edhe ni plan i veprimit që komuna e ka obligim me ndërmarr veprime për ta përmbushur planin dhe monitorimin e këtyre veprimeve. Pra, të nderuar. Plani i veprimit, ne cilin ka dështu komuna me i paraqitë, është në datën 30 shtator dhe 31 mars. Asnjëherë nuk kam marre përgjigje pse plani i veprimit mbi zbatimin e veprimeve dhe rekomandimeve nuk ka ardhur në Kuvend. Faleminderit. Nuk ka mi tregu procedurat, veprimet që i ki ndërmarr. Kjo është obligim ligjor e nderuara drejtoreshë, komuna nuk ka raportu në Kuvend. Jo nuk ki raportu në Kuvend janë afatet ligjore 30 shtator dhe 31 mars, ku ti 30 shtator 2024 dhe 15 tredit 2025 afati ligjor që kërkohet të diskutohet çështje lidhur me progresin e rekomandimeve. E ti këta nuk e ki bo. Faleminderit.

Hajdar Sutaj

Unë edhe po patjetër edhe të falenderoj edhe të përgëzoj për studimin që i ke bo materialit, urdhereo drejtoreshë.

Dafina Cacak

Në lidhje me raportin, për zotimin që e kom bo, është shumë e vërtetë që kom thonë që kemi mu përmirësu dhe u përmirësu. N'viti 2022 kemi pasur shtatëmbdhjetë rekomandime edhe sot kemi ardh me shtatë rekomandime. Edhe nuk janë rekomandime që munen me u rregullu sot për nesër. Normal që duhet puna e krejtve për mu u rregullue dhe nuk janë punë që kryhen për ni ditë, që mu rregullat tanat për ni vit. Jemi përmirësu nga viti në vit shumë ma shumë sa që kemi pretendu. Ndërsa për planin e veprimit, plani vjen me raportin e auditimit, ia kom pru, ndërsa, raporti unë e kom përcjell te Zyra Komtare Auditimi. Ju nuk ma keni kërkuar une nuk e pasna ditë që kom ligjërisht me raportu para juve. Mirpo publiku edhe dërgu zyrët komtare e kemi, sepse kemi obligim ligjor me ia u dërgu aty. Me mpas thirrë nashta edhe e kisha pru, po une se pasna dite që kom obligim me e pru te ju. Për këtë vit tash e di.

Hajdar Sutaj

Falemnderit shumë, Z.Vatan Istëri e ka fjalën nga LDK-ja.

Vatan Istëri

Faleminderit për fjalën, kryesues. Përsëritet të gjithëve njëherë. Pasi që po bisedojmë pra për raportin e auditorit të jashtëm për komunën e Deçanit, vlen të ceket që e keqja është se ka dalë me një opinion të kualifikuar, pra me shtatë gjetje. Nëse e shohim nga rëndësia, secila ka rëndësi më të madhe se tjetra. Po ashtu që e kam vërejtur në këtë raport, është se në dhjetë raste përmendet fjala mashtrim ose gabime tek përgjithësia. Pra, nëse marrim këtë aspektin teorik, mundemi me kuptu, por, nëse e shohim gjithashtu kur ka shënim, pra, cekur në këtë rast i bjen që është keqmenaxhim. Ndër gjetjet kryesore të cilat duhet t'i përmend, pra janë vanimi pagesave nën 1. Po ashtu, njëra që ka rëndësi shumë është emërimi dhe angazhimi i zyrtarëve për kryerjen e shërbimeve të veqanta, jo ne pajtueshmeri me ligjin, me ligjet dhe rregullat e zbatueshme. Pra, Kryetar ti ki, ki angazhu tridhjetë e tre persona, pra, staf. Pa procedurat e rekrutimit, pra kur shumica prej tij janë pjesë e administratës, pra 26 prej ty janë pjesë e administratës. Hajde megjithatë, nëse janë shtatë në shendetesi, ndoshta kishi mujt me i kuptu. Pra, këta në administratë, kryetar i ki njëqind e trëdhjetë persona në administratë deri tash. Besa ka fjalë që në

administratë ka njerëz që s'dalin në punë kurrë, vetëm pse mundën me qenë militant të partisë. Pastaj është një tjetër kur e marrim këtë shembull që ki angazhu rreth trëdhjetë e tre persona jashtëligjshëm, del tjetra mungesa stafit tek auditimi i brendshëm. Gjithmonë auditorët e jashtëm po të japin rekomandime që komuna jonë i plotëson përmasat për ti patur tre auditorë të brendshëm. Atëherë pse kryetar nuk po e merr këtë hap dhe me shtu auditimin e brendshëm me bo ma cilësor, pasi që rekomandimet po na vijnë çdo herë në rritje dhe pothuaj s'janë të përsëritshme vit pas viti. Faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Vatan. Dikush tjetër? Miftar Ahmetxhekaj kryetari po don mu përgjigj në fund. Thuaj dhe ti qa ki me thene tema tua.

Miftar Ahmetxhekaj

Falemnderit shumë për sygjerimin. Kryetar, e para nuk ka asnjë dyshim se një prej dokumenteve më të rëndësishme është raporti i auditimit. Është raporti i cili ty t'i pasqyron veprimet ose pagesat ose secilin veprim që ke marrë. Mu me kujtohet praferësisht para katër viteve, drejtoresha për Financa, perafersisht spo du me gjyku, po perafersisht përgjigjet kanë qenë të njëjta. Do të përpiqem për më mire, mundesh mu arsyetu me rekomandime me zvogëlimet e rekomandimëve, po konkluzionet, te cilet e kanë pru këtë përfundim ose këtë pasqyrim janë perafersisht te njëjta. Qe nga vlerësimi i gabum, qe nga kontratat, dhe pavarësisht që kryetari paraprakisht e tha si me mburrje, pavarësisht ni farë forme penalizimit, unë mrri mi kryj pagesat. Nuk është shenjë e mirë nëse eventualisht tridhjetë përqind të buxhetit i pagun me, me permbarim. Është shumë! Për shkak se, kostoja e këtij 30% është 8% është tarife. Që nëse eventualeisht i hekem tetëqind e diçka mije euro te kontrates kolektive i bie që, I bie qe dikun 350 mije I keni pagu duhet me I pagu tatim, dmth duhet me I pagu penalizim, qe sikur ti te ishe me I kujdesshem ne realizimin ose ne detyrat tua absolut do ti ikshe penalizimit, kaq kryetar faleminderit shume.

Hajdar Sutaj

Faleminderit Miftar, kryetari ka fjalën.

Bashkim Ramosaj

Falemnderit! Po munohem me jep ni përgjigje të përbashkët, sepse perafersisht është I njëjti, i njëjti shqetësim është. Unë e kom kuptu, kom, kom besu që mundem mja u spjegu njerzve për me kuptu edhe këta sikur une qka oshtë auditimi jashtëm ose ça oshtë ekuivalenca mes buxhetit, menaxhimit ose mirëmenaxhimit dhe ne raporti pozitiv të auditorit ose auditimit jashtë. E kur hin në keto tri dimensionet dhe menon se cilin duhet me respektu, une prapë me m'kthi ne kohë, une prapë njejtin gjë a kisha bo. Për nje arsye te vetme. Ajo ç'është buxhetore, dihet tash që oshtë ni planifikim të cilin ti nuk e me mujt kurrë me implementu deri sa ballafaqohesh me ato që tha më herë. Sepse ta prish skemen e planifikimit. Dhe ekuivalenca që behet në këtë aspekt me menaxhimin ose me mirë menaxhimin, e që janë tema ose subjekt i auditorit të jashtëm, ta jepin një te dhënë. **O duhet me najtë banorë më shumë në këte** qytet, o duhet me ecë përpara në këte far forme. Dhe unë e kom zgjedh keta te parën që me ec pak më përpara. E normal që përgjegjja e sinqertë, e të gjithë neve, e imja kryesore, e Drejtorisë për Financa e drejtorëve të tjerë, e duhet të jetë përpjekja jonë maksimale që me i zbut këto rekomandime. Faleminderit

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë, kryetar! Vazhdojmë te pika e pestë. Shqyrtimi i raportit gjashtëmujor të Zyrës për Barazi Gjinore. Fillimisht e kisha kalu fjalën te zonja Ajne Iberhysaj.

Ajne Iberhysaj

Pershendetje kryetar, kryesues, anëtarë të asamblesë, shoqërisë civile. Meqënëse raporti gjashtëmujor është kërkuar, është hartuar sipas Planit Komunal për Barazi Gjinore 2023-2027, është kërkuar edhe Raport vjetor Planifikim Vjetor sipas kërkesave që është ardhë sipas performancës ku janë përfshirë gjithashtu edhe aktivitete. Në Planin Vjetor të vitit 2025 janë gjithsej gjashtëmbëdhjetë aktivitete të identifikuar të cilat për tu realizuar për vitin 2025. Nga këto janë realizuar gjashtë, të cilat i kom arsyetu, dokumentu, përveç pra prezentimit në ueb faqet komunes po gjithashtu janë të përfshira edhe në këtë raport. Pjesëmarrja e të ciles është e marrë gjithashtu edhe në punëtorit dhe trajnimet, të cilat janë qenë e domosdoshme për ta përfaqësuar Zyren për ata të cilët po kanë mungesa informacionit atëherë po ritheksoj, sepse unë jam me vendim të Kryetarit të komunes prej vitit 2023, për të ndimuar, lehtësuar, punën e ish koleges tonë, që me datën dy shkurt të këtij vitit është pensionuar. Dhe, nga viti 2023, më shumë se sa unë që jam dalë përballë juve, që dot mbani mend mu dhe unë juve, të memorizuar. Po ju them zënkërisht, me plane, me aktivitete, të cilat më dasht raportoj. Kërkesa që është ardh gjithashtu për raport, për Planin për gjashtë mujor këtij vitit. Atëherë, përveç që ka munguar vullneti i anëtarëve të Asamblees Komunale për themelimin e Komitetit për Barazi Gjinore, ka munguar gjithashtu, që unë duhet ta theksoj, sepse është themeluar edhe Mekanizmi Kundër Dhunës në Familje. Rastet të cilat të raportuara për vitin 2025 nga Stacioni i Policisë janë gjithsej 13 raste. Nente janë gra dhe katër ato cilat janë gjinisë mashkullore. E keqja të cilën unë duhet ta theksoj, nuk është ëh, megjithatë që duhet ta ngris, se pjesë e mekanizmit është edhe, ëh, shtëpia e sigurisë, e cila është pjesë e mekanizmit, nuk janë bere pagesat për vitin 2024 dhe deri në këtë datë. Dhe ku qëndrimi, të cila ballafaqohen ato gra me dhunën dhe duhet të shkojnë për të qëndruar në atë shtëpi të sigurisë do të ishte, e mira, s'mires sa ma shpejtë dhe sa ma efikase janë këto pagesa, sepse është e domosdoshme, të jemi përgjegjës ndaj pikërisht ato të cilat kanë nevojë dhe ballafaqohen me dhunën në familje. Unë nuk kam më shumë çka të shtoj. Nuk ka rëndësi, sepse prej vitit 2023, nuk gravitoj në asnjë pagjes, që jam pagu në të gjitha rregulloret, në të gjitha planet të cilat po marr pjesë. Kështu e kom kry punën time dhe për pjesën e dytë, gjashtëmujorshi i dytë nëse kërkohet në raporte do të jem edhe une e përgjegjshme, sepse duhet ta vlerësoj vone veten time. Nëse nuk paguhem, edhe unë nuk raportoj. Jo, ju lutem, sepse janë raporte që i kanë në agjencion antikorrupsion për Planin e Integritetit. Është Raporti i Zyrës së Koordinatores kundër Dhunës në Familje, Zyrës së Kryeministrit, që është obligativ, kështu që edhe unë... kushti është kusht. Faleminderit kryetar, respekt.

Hajdar Sutaj

Në emër të grupit të AAK-se Arian Dobraj.

Arian Dobraj

Me e përgëzu... Ndoshta s'kem nevojë me e thonë se e kem thonë tana herët për shkak të punës të madhe që e bon. Po i vëreja vetëm dy gjanat që duhet mi përmend. E para është menijer faqe realisht faqe tre, të lista e përfituesve që i kanë nda në përqindje sipas gjinisë femërore dhe mashkullore, e pashtë që shifra totale që keni përfituar vetëm 6500 euro, po m'dok pak e vogël, për shkak se ne jemi tu folur natë pjesën se duhet mu përkrah sa ma tepër gjinia femërore. Edhe në fund kam një vërtitje, që kemi realisht si grup, ku ke thanë që... Po citoj: "Ka munguar vullneti dhe nisma konkrete për themelimin e Komuniteti Komunal për Barazi Gjinore". Unë nuk e mbaj mend që na ka mungu ndonjëherë vullneti dhe ose entuziazmi ose dëshira për me formu diçka tillë. Bile, ne jemi kon ata që shpesh kemi jep ideja, që

mundem me ta ngjitë dorën në ato punët dhe detyrat që ti, që i ki pjesë të përditshmërise tane.
Faleminderit!

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë Arian. Po, kështu, unë kisha menduar që me i marrë ti qeto edhe me u pergjigj në fund.

Ajne Iberhysaj

Atëherë sa i përket pyetjes se Arianit, ju faleminderit Arian, për pyetjen. Megjithatë, ka rëndësi që nje OJQ, e cila përfaqësohet, është udhëheqëse nga gjinia femerore, grua. Është e rëndësishme të mbështete përkrah. Në mesin e grupit, i cili thotë, lista është e publikume në faqet e komunës. Mesin e atyre që osht bërë cilat janë përfituese, që udhëhiqen keto OJQ nga grate, janë gjashtë, dhe pjesa tjetër të cilat ishin të drejtohen nga gjinia, sigurisht nga burra. Megjithatë po referohem të dhanes tjetër, te cilen ka te beje mbështetja përkrahja me pajise, te cila është edhe Drejtoria e Bëjqësisë që e ka dhënë për vitin 2025, sa gra po referohem, ashtu siç ka cekur drejtori meqenese është prezent, mund të ket edhe replikë. Është sa gra kanë aplikuar për grante në këtë Drejtorinë e Bëjqësisë janë mbeshtet, sa gra kanë aplikuar për tu mbështetur, OJQ janë mbështetë nga komuna Deçan. Numri është gjashtë, unë nuk e muj ta bëj shtatë, sepse nuk kemi pat. Atëherë sa i përket pikërisht vullneti nuk ka munguar. Nismat janë të mirëseardhura, por nuk është konkretizu. Kanë mbetur gjithmonë, gjithnjë e vetëm vullnet. Dhe do të ishte shumë mirë që ta kishim pikërisht gratë asambleiste, një zë shumë i fuqishëm, një zë, të cilin për të përfaqësuar në mënyrë sa me mire duke u bazuar gjithmonë në objektivat te cila kanë pasur tek Plani Komunal për Barazi Gjinore, ku pjese ati planit është themelimi dhe konstituimi, veprimi, funksionalizimi i këtij komiteti.

Hajdar Sutaj

Në emër të LDK-së, Albesa Cacaj.

Albesa Cacaj

Përsëndetje edhe niher. U deklarua këtu zonja Ajna që na nuk kemi kërku me sjellë raportin lidhur me planin i cili është miratuar në vitin 2023. E nderuara Ajne, me shumë respektin që kam për ty, janë ca gjana te shkruje të cilat nuk ke nevoj mi kërku, po që je obliguese mi bo në momentin që ti e harton ni plan edhe në faqen e fundit te Monitorimi dhe Zbatimi, thuhet konkretisht: „Zyra për Barazi Gjinore e ka për detyrë të informojë në mënyrë të rregullt për arritjen e objektivave dhe realizimin e aktiviteteve të parapara në Planin Komunal për Barazi Gjinore, që ka kohëzgjatjen 2023-2027". Pra, është një plan për periudhën katërvjeçare, si dhe të paktën një herë në vit, kryetari i komunes raporton në lidhje me përmbushjen e objektivave të cilat janë paraparë në këtë plan. E kom pa, e kom lexu planin, po aktivitete të cilat, ti i ke hartu ne ket plan e jonë të ndara në tri shtylla, osht për keqardhje realizimi tyne, me faj ose pa fajin tënd. Unë e di që është dashtë edhe mjete financiare, po gjitha jonë te saktesueme, nëse m'lejohe veç pikat kryesore, sepse sinqerisht ka shumë. Kush e ka planin, munet munet me e parë realisht. Jon ndame në tri, për shembull këtu thuhet subvencionimi i pagesës për kopshtet e fëmijëve të nënave vetëushqyese përfituese të skemave sociale. Unë besoj gjithë jemi dëshmitarë se kjo nuk bohet. Domethënë ka shumë e shumë kësaj pika edhe aktivitete që janë paraparë, po thjesht mbesin në letër të paralizume. Edhe nje, po m'vjen kështu shpesh me theksu qet fjalim, po kishim dasht që të jetë kështu. Të paktën pesëdhjetë përqind e planit realizohet, po këtu janë thjesht obligime që dalin obligime ligjore që ju i merrni, e kini obligim mi realizuar, por jo në praktikë. Thjesht obligim kështu ligjërisht, kaq. Domethënë

nuk, nuk jemi të kënaqur. Besoj që as donja Ajna nuk është e kënaqur me realizimin e aktiviteteve të cilat janë paraparë në Planin e Veprimit për Barazi Gjinore. Faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit, Albesa! Prej vetëvendosjes a don dikush. Teuta Neziraj ka fjalën.

Teuta Neziraj

Pa dashtë me bo njifarë, me ja vendos fajin askujt, fajin pe lojme atë kuptimin jetim. Ajna thotë grate asambliste, na thojnë jo ajo jo kjo. Po e rëndësishmja është që mirë që ka ardhë mu shqyrtu ky raport. Edhe qka mu mla ma shumë përshtypje ke, Ajna m'duket tha se nuk e kuptova mirë nuk janë pagu viktimat prej 2024. Nëse mundet mu përgjigj kësaj pyetje. Ah ok, se ke çështja te pagesat edhe se kuptum kush nuk u pagu ktu tashti, nrregull mirë. Qe veq pe përfundoj tani. Edhe çka është një iniciativë që unë e mora për pozitive, ke te drejtorja për bujqesi. Angazhimi i një eksperti të jashtëm, domethënë që t'ju ofroj asistencë drejtpërdrejt grave për përgatitjen e aplikacioneve për përfitimin nga skemat e granteve dhe subvencioneve, që është taman ni note me thon vlerësuese se jo shumica munën me njoft procedurën rreth aplikimit edhe kjo është taman ajo çka duhet një përkrahje që duhet atyne me ju jep këtyre grave. Faleminderit.

Hajdar Sutaj

Falemnderit shumë! Moni nuk është lajmeruar për fjalë. Aha ok, Mon Selmanaj e ka fjalën.

Mon Selmanaj

Faleminderit,

Hajdar Sutaj

Kërkoj falje,

Mon Selmanaj

Nuk kam diçka rreth këtij raporti me përjashtim në faqen tre. Ku tabelën numër një që e ka ofruar Ajne Iberhysaj, nën 1 përmbledhjet e përfituesve sipas gjinisë, mendoj se është dashtë të na ipet në formë tabelare të na paraqiten emërtimet e këtyre organizatave joqeveritare, sepse ky është një dokument zyrtar. Një raport zyrtar që vjen dhe duhet të ketë të dhëna zyrtare. Mendoj, unë mendoj që është dashte të gjitha këto organizata të udhëhequra edhe nga burrat edhe nga gratë të jenë me emertime në këtë tabelë. Kështu që për hera të tjera e nderuara Iberhysaj kish qene mirë me e përmirësu. Falemnderit!

Hajdar Sutaj

Faleminderit, zotëri Mon! Yllarta Thaqi pastaj Orges Tafilaj.

Yllarta Thaqi

Falemnderit shumë! Sa i përket raportit, nga fillimi e kom lexu me vëmendje edhe pse kemi marrë shumë kritika si grupi i grave asambleiste. Po sido që të jetë s'ka problem. Kritikant janë për njerzit që punojnë. Te faqja tre edhe unë punë ndalna te fundi derisa është rekomandu për shembull edhe për shkollat e cilat janë një numër jashtëzakonisht i madh i shkollave, 20 shkolla dhe 4 katër psikologe atëherë ky rekomandim shpresoj që ka shku në vend se njëzet shkolla me katër psikologë është qetësuese për numrin e madh të nxënësve. Jo vetëm të mbetet më në letër i shënuar. Ndërsa tek faqja 5 ka gabime gjuhësore kur flasim për gabime gjuhësore janë të pashmangshme te dokumentet që na vijnë çdo herë. Ndërsa sa i përket faqes së fundit si rekomandim që e ka përgatitur ushtrusja detyruese zyrtare për barazi gjinore është pak prekëse sepse na prek të gjitha neve. Ko me lexu komplet faqen edhe jap rekomandim. Nevoja për themelimin e komitetit komunal për barazi gjinore ka munguar vullneti dhe nisma konkrete për themelimin e komitetit komunal për barazi gjinore, që do të përfshinte në mënyrë aktive gratë asambleiste në bashkëpunim me Zyrën për Barazi Gjinore në Komunën e Deçanit. E tejkaloi këta mungesa një motoje të përbashkët dhe vizionit të përbashkët ndërmerre grave asambleiste edhe zyrës për barazi gjinore ka qenë një bashkllëk i ndjeshëm në këtë periudhë katërvjeçare shumë vajtuese. Shpresoj që në të ardhmen ky partneritet do të forcohet dhe do të krijohet një bazë e qëndrueshme për rritjen e pjesëmarrjes aktive të grave në zhvillimin ekonomik, duke i rikthyer mesazhin e fuqishëm se gratë nuk janë konkurente por bashkëudhetare dhe se gjithmonë një grua duhet t'i zgjat dorën njëra tjetrës grua. Mendoj se mungesa fillimisht ka qenë nga zyrtaria për barazi gjinore, e cila për shkaqe shëndetësore vitin e fundit nuk ka qenë aktive. Mandej, ushtrusja e zyrëtares për barazi gjinore e ka anashkuar Grupin e Grave Asambleiste. Thëksoi se na kemi organizuar aktivitete por Zyrëtarja për Barazi Gjinore nuk ka qenë pjesëmarrëse me neve në aktivitetet që kemi organizuar ne, edhe pse nuk kemi funksionuar si Grup i Grave Asambleiste, po kemi qenë të koordinuara me njëra tjetren sa i përket aktiviteteve që i kemi realizu. Kemi bërë vizita, njëkohësisht kemi shënuar edhe aktivitetin e sensibilizues për kancerin e gjirit, për shkak kemi vërejtje edhe prej kolegëve asambleistë s'kanë qenë pjesëmarrës por vetëm Drejtoria për Buxhet dhe Financa na kanë mbështetur. Do të kjo kërkesa jonë është mbështetur. Njëkohësisht Zyra për Barazi Gjinore konsideroj se mrena katër vite asnjë email, asnjëherë prej kolegeve tanë nuk i ka ardh prej Zyrës për Barazi Gjinore për pjesëmarrje të ndonjë aktiviteti edhe njëkohësisht edhe grupi që është formuar prej Asambleje për hartimin e planit për barazi gjinore nuk është thirrë për hartimin e planit për barazi-gjinore. Është ardh i gatshëm plani për barazi gjinore edhe na e kemi votu duke marrë parasysh se ato aktivitete do të realizohen mrena këtij mandati. Sido që te jete lus kryetarin, hape ni konkurs, punëso ni zyrtar për barazi gjinore dhe shpresoj mendatin tjetër se ka me hec punë pak më mirë. Falemnderit.

Hajdar Sutaj

Te falemnderit Yllarta, Orges Tafilaj ka fjalën.

Orges Tafilaj

Falemnderit, kryesues! Ajne përgëzim për punën edhe punët tjera vullnetare. Besoj kjo çështja e pagesës duhet koordinohet me kryetarin dhe drejtoreshen për financa. Tek pjesa e raportit, fillimisht kur na ka ardh plani veprimi për barazi gjinore, kam thënë dhe kam pyetur në fund sa beson që ky plan do të realizohet deri në fund. Sot, ne baze te këtij raporti nga gjashtëmbëdhjetë aktivitetet e parapara janë realizuar vetëm gjashtë. Domethënë janë dhjetë paralizime dhe nuk besoj që deri në fund do realizohen edhe të dhjetë tjera. Domethënë, ai dyshimi fillestar ka dalë që ka qenë i bazuar. Te faqja e dytë pse osht e panumërizime, besoj janë bërë disa lëshime matematikore, teknikisht ose gabimish. Te arsimi Pika 2, ku thuhet që nënpunë të shërbimit publik gjithsej 432 persona, prej të cilëve 168 janë burra dhe 171 janë gra. Besoj që është gabim, duhet përmiresohet te stafi administrativ dhe mbështetës gjithsej 141 persona, 96 burra dhe 38 gra, prap duhet përmendësohet, dhe tek tabela ku është paraparë buxheti për

subvencionim në vlerë prej 350,000 euro, i ndarë barabartë mes burrave dhe grave. Besoj se kjo pjesë pastaj do të jetë 175,000, 175,000. Pjesa tjetër normalisht që pajtohem edhe unë që grupi i grave asambleiste ose këshilltare komunale duhet funksionojë, por jo në këtë moment. Besoj që kjo është dashtë të bëhet shumë më herët dhe ky grup të funksionoi si i tillë kompakt dhe ti kryej detyrat e veta. Faleminderit!

Hajdar Sutaj

Atëherë koleg, meqenëse nuk kemi diçka tjetër me diskutu, e permbylлим si pikë raportin, domethënë shqyrtimin e raportit gjashtmuor. I përgëzojmë zyrën përkatëse për punën që kanë bërë, zyrtarën Ajne Iberhysaj dhe ju deshurojmë punë të mare dhe te suksese.

Hajdar Sutaj

Jemi te pika gjashtë Raporti i KKSБ-së. Prej grupit AAK-se, drejtor a do me thonë diçka mbi temën? Izet Zenuni e ka fjalën.

Izet Zenuni

Faleminderit, kryesues! I keni dy procesverbale të takimeve që janë mbajtur te KKSБ-së, dot të thot rekomandime që kanë dalë nga KKSБ-ja edhe pjesëmarres që kanë qenë prezent. Eshte obligim që çdo gjashtë muaj KKSБ-ja ta ketë një raport para Asamblesë Komunale, për shkak te performancës edhe arsyjeve që ju nevojiten. Në qoftë se keni diçka mundem me pyte, nuk kom diçka tjetër.

Hajdar Sutaj

Falemnderit shumë drejtor! Po e lo veç diskutim të lirë. S'ju obligoj kerkend prej grupeve. Nese eshte dikush qe ka diçka me thonë urdheroni. Faton Selmanaj urdheroni, në emër të vetevendosjes.

Faton Selmanaj

Faleminderit Kryesues! Përsëndetje drejtor, unë pata dy kërkesa për këtë kohë. Me ja drejtu drejtorit kështu. Trotuaret janë shumë të nxone edhe përbajnë një rrezik shumë të madh për qytetarë në këtë kohë. Kshtu që po të kërkoja edhe po të lus se me pas një bashkëpunim sa ma të mirë edhe me polici edhe me mekanizmat e tjerë të cilat i ki në dispozicion që me i liru, sepse më te vërtetë janë tu përbe një rrezik shumë të madh. Besoj që e keni pa edhe ju bash prej Urës Demës deri në fund të carrabregut komplet te nxone janë çdo ditë.

Hajdar Sutaj

Shumë e vërtetë, Arian Dobraj ka fjalën.

Arian Dobraj

Faleminderit Kryesues! Deshta vëtëm me shkurt meqë jemi te siguria në bashkësi. Kisha kërku që komuna me intervenu në vendosjen e vendkalimeve, domethënë shenjizimin e vendkalimeve sidomos afër shkollave, për shkak se ka ni mungesë të theksuar, kështu qe kisha kërku me marrë parasysh këtë kërkesë. Faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit po ashtu Arian! Fjalën e ka Orges Tafilaj.

Orges Tafilaj

Faleminderit Kryesues! Realisht edhe hera tjera kam kërku që nëse ka hapësirë ligjore do ishte mirë që gjithë spektri politik që ekziston Deçan të ketë te paktën një përfaqësues në KKS. Ndoshta do i kontribuonte edhe me mirë siguri në vend edhe pjesa tjetër është që e kam ngritur si qeshje shumë herë është çështja e rrugës që dergon te Manastiri. Për shkak të frekuentimit të qytetarëve, besoj që duhet në koordinim me Policinë të ketë më shumë policë në atë zone, ndoshta patrullime ma të shpeshta, në mënyrë që mos rrezikohet jeta e qytetarëve për shkak të shpejtësisë së makinave që po zhvillojnë në atë rrugë. Faleminderit.

Hajdar Sutaj

Falemnderit shumë Orges! Drejtor a ki diçka me thonë? Drejtori Izet Zenuni ka fjalën.

Izet Zenuni

Shqetësimin që e ngriti Fatoni osht edhe takimet në KKS po edhe takimet që ka kryetari bashkë me neve ditore apo javore me policinë. Shqetësimi i njëjtë iu përcillet policisë. Ata prapë së prapë duke pa edhe fluksin e madh të njerëzve dhe veturave që kanë ardhur edhe gjrobat që i kanë tre fishume qet sezon, prap se prapë avazi osht i njëjtë. Shqetësimi ktu qe i përcjelli çdo ditë apo çdo takim qe kemi me policinë. Sa po kane efekt është problem me, me e qartësu si teme. Te shenjizimi Arian që tha është mirë me dit se shumica e shkollave kanë shenjizime, po te ni shkoll që nuk ka, meqenëse kompania e shenjizimit osht në terren tuj e bo edhe per emertimin e rrugës edhe fshatrat. Osht mirë me dite edhe me, me e përcjell si, si shqetësim edhe me qu te menaxheri kontrollues për me e kryer. Te pjesmarja në asamble te asamblista sidomos opozitës, dot thote KKS-jë përveç eshte e marune ne baze te nje udhezimi administrativ dhe ti përcakton edhe organet që kanë qenë pjesë e sajna. Po në cilësinë e vëzhguesve, në cilësinë e vëzhguesve, absolut nuk osht diçka keqe që me qenë pjesë e KKS-së edhe pjesa e Asamblesë qoftë e opzites apo pozites.

Hajdar Sutaj

Të falenderoj shumë për sqarimet. Kalojmë te pika e shtatë. Shqyrtimi dhe miratimi i draft rregullores për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës ne Administratën Komunale. Ashtu siç e dini, e kemi diskutu edhe në mbledhjen e kalume ku e kemi votu si draft. Kjo ju ka nenshtu edhe ni diskutimi publik dhe nëse ka pasur rekomandime të cilat janë drejtune Zyrën e Burimeve Njerëzore, osht udheheqesi i Zyrës Menaxheri i Burimeve Njerëzor Z. Enver Cacaj që fillimisht e kisha lutur me marrë fjalën. Dhe pastaj, ta hapim diskutimin.

Enver Cacaj

Atëherë, përshendetje për të gjithë, faleminderit kryesues për fjalën. Ashtu qysh e potencoj edhe kryesuesi, pas mbajtjes së debatit publik me datën 17, që kanë ardhur disa rekomandime, e kemi bërë një takim zyrtar me gjithë drejtoret e drejtorive dhe është vendosur mu inkuorpo rekomandimet që janë konë nga dy drejtori edhe rekomandimet e Kuvendit. Qato rekomandime janë inkuorpuar në rregullore. Rrekomandime tjera nuk kemi pas. Nëse kini lexuar materialin që keni apat naj verejtje, ate dite ne KPF e kom potencu u kon një gabim teknik te drejtori qendrës për punë sociale, ku duhet vendosur drejtori dhe jo udheheqesi. Diçka tjetër nuk kemi pasur. Në shërbimin publik janë kon disa propozime që me kryetarin jane vendosë cilat mu vendos, edhe pozitat, që jane kanë propozime te Kuvendit. Diçka tjetër, ndryshime nuk ka ne rregullore.

Hajdar Sutaj

Kolegë mundem me ju njoftu qe kërkesa e Kuvendit që ka qenë, është inkuorpuar, domethënë e tëra në kuader te rregullores. Nuk e di Enver kanë qenë disa propozime prej sekretares së kuvendit te keto professional qe ndahen keto me nivele nuk e di a I keni planifiku.

Enver Cacaj

Në material nuk kemi, nuk kemi ndryshu kurgjo prej KPF-së. Dyka e ka propozu, mu vendos ni pozit zyrtar i lartë zyrtar për punë të Kuvendit, ka propozuar zyrtar i lartë.

Hajdar Sutaj

Po, po, e kuartë

Enver Cacaj

Tash qysh ta votoni na mundemi, mundem mi bo ndryshimet pa shku rregullorja mi bo ndryshimet mi miratuar, a doni mi vendos mi lon zyrtar të lartë a mi lon zyrtar. Kështu te vendosim sepse në Kuvend për momentin janë udhëheq te sektori për punë të Kuvendit, zyrtarë për çështje të Kuvendit Komunal, zyrtarë për Lekturimë, zyrtarë për përkthime edhe asistent administrativ. Këto pozita jane, Dyka ka rekomandua ate ditë në KPF. E kemi diskutu me u vendos zyrtar i lartë për çështje të Kuvendit Komunal. Është qasjes ni te arsyeshme se vendosim zyrtar të lartë. Unë atë ditë bila pak unë humor thashë po vendosim gjithë zyrtarë të lartë.

Hajdar Sutaj

Enver me ta bo një pyetje, nëse ke mundsi me ja jep nje përgjigje. Është edhe një kërkesë e Drejtorisë së Arsimit që na ka ardh ni shkresë. Na ka dorëzu dhe kopje fizike, a mundesh me na thonë per qfarë bëhet fjalë?

Enver Cacaj

Unë shkresë, kur është ardhë ajo shkresë?

Hajdar Sutaj

Neve nau ka drejtu, ju ka drejtuar kryetarit, mu edhe Kuvendit edhe juve ne CC je.

Enver Cacaj

Me cilin datë?

Hajdar Sutaj

18.07.2025

Enver Cacaj

Po.

Hajdar Sutaj

Që mundesh me marr.

Enver Cacaj

Sa i përket kërkesë nga Drejtoria për Administratë, për Arsim m'falni, është kërku që me pas zyrëtar ligjor në kuadër të drejtorisë, ku rregullorja parasheh sektorin ligjor për komplet organizatën buxhetore. Sa i përket rregullores së katalogut të vendeve të punës, sipas vendimit qeverisë 23.10.2024, është e rregullume sistematizimi për gjitha organizatat buxhetore, ku osht një sektor ligjor për gjithë organizatën buxhetore është Drejtoria për Buxhet e Financa, ku i përfshinë tri sektore: sektorin e arsimit, shëndetësisë dhe administratën, osht si kod buxhetor. E ndërura kolege Gjylshahe deri me tani o kon përgjegjese për Buxhet e Financa në kuadër të Drejtorisë për Arsim tashmë me rregullore të re kalon zyrtar e lartë për Buxhet e Financa në kuadër të Drejtorisë për Buxhet e Financa, sepse disa pozita ose disa zyrtarë munden mu ndrru nga një drejtori me kalu në një drejtori tjetër. Nuk osht asnjë pozitë që shuhet për zyrtarët momental që janë ose që dikush papunë munet mu ndrru prej një drejtorie me kalu në drejtori tjetër. E jepi edhe sqarimin. Sa i përket përshkrimit të detyrave punës, përshkrimi individual i pozitave nuk kalohet në Kuvend. Përshkrimi i pozitave osht i përshkrum të gjitha pozitave kur kalohet rregulloria mbikqyresi drejtë për drejtë, me cdo zyrtar e nënshkruen pajtimin e përshkrimit të pozitave të punës. Jon përshkrime po nuk bohen publike. Përshkrimi i detyrave punës nuk osht publik, osht vetem përshkrimi edhe organizimi edhe sistematizimi i drejtorive në rregullore. Përshkrimi individual. Çdo zyrtar ka me pasë, e ka. E ka në fakt osht e hartume nga eksperti. Kur të aprovohet rregulloria çdo zyrtar keni me pasë edhe përshkrim detyrat e punës.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë. Dikush tjetër diçka? Albësa Cacaj.

Albesa Cacaj

Pse do duhej sikur drejtoria që ka, paska bo kërkesë të ketë një zyrtar ligjor, sikur Zyra e Kryesuesit, t'u e marrë parasyshë faktin se zyrtari ligjor e ka zyrën edhe osht në ekzekutiv, pse do duhej secili sektor ose secila drejtori me pas qeta nuk e kom te qarte. Edhe e dyta pyetje Enver esht, a i nenshtrohet ligjshmerisë, kjo draft rregullore ku sot... Ok, faleminderit, kaq kisha.

Hajdar Sutaj

A kenë mundësi te Enveri me e lshu mikrofonin?

Enver Cacaj

Sa i përket pyetjes se parë, sipas rregullores themelohet sektori ligjor, deri më tani kemi pasur vetëm zyrtar ligjor, me rregullore të re parashihet sektor ligjor. Pytja tjetër, po i nenshtrohet ligjmërise..ministri financave.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë. Dikush tjetër diçka, Vatan Isrefaj?

Vatan Istrefaj

Faleminderit për fjalën, kryesues. Së pari një vërejtje tek rendi i ditës është shënuar shqyrtimi i draft rregullorës. Kjo sot e merr versionin final dhe shkon për shqyrtim në MAPL. Po kjo votohet se sod o ardh si rregullorë kështu a din tash, kjo sot e merr implementimin e vet. Po ashtu I nderunë ne e kemi diskutuar në Komitetin Politik Financa, por kjo rregullore më shumë ka të bëjë, për shembull vetem me sistematizimin e vendeve të punës, apo për shembull pas kërkesës që ka bere Drejtoria për Shërbime Publike për shtimin e punëtorëve në atë drejtori, a do rritet edhe numri i punësuarve me këtë rregullorë, apo jo? Arsya është pasi që viti e ardhshem grantet qeveritare do të bie për tetëqind mijë euro, pastaj do të kem implikime buxhetore për këtë pjesë po flas.

Enver Cacaj

Po faleminderit, ashtu qysh e potencuam edhe ne KPF Vatan. Materiali është ardh pak si shpejt e shpejt, në atë kuptimin popullor, sepse u vanu me debat publik u majt me datën tetembedhjete, na e vendosem dej me datën 21 me ardhe rekomandimet, me të 21-tin e majtem ni takim zyrtar me kryetarin dhe drejtorat. U rekomandun disa ndryshime, dej sa u bon çato ndryshime u vanu pak më material. Ate dite edhe Dyken e arsyetova, n'këtë veprim kur erdha thash, nëse u vanu nmateriali nuk oshtë faji I Dykes, që nuk është ardh fizikisht materiali po jemi vonu për qeto arsye. Gjithashtu edhe te emërtimi si draft rregullore është ardh, se nuk kemi pas hapësire ose kohë për mi bo qato korrigjime.

Sa i përket pozitive, Vatan, e kemi diskutu, prap po e potencoj, e kemi diskutu edhe herën e parë kur u kon si lexim i parë. Është rregullore për sistematizimin e vendeve te punës. Tashti mundem me planifiku dyqind pozita shembull, sa kemi me i pas te realizushme, është pikëpyetje si. Unë na që shpeshherë besoj se shum pak kemi pas mundsi me planifiku, se kur vjen tash Dafina, mundet me dit ma mirë. Për një afatmesem buxhetore përfundimtar nuk e dijme sa ka me ardhe numri i te punesuarve, domethen me parapa mundesh pozita, por mi realizu eshte krejte qeshtje tjeter.

Hajdar Sutaj

Mon Selmanaj e ka fjalën.

Mon Selmanaj

Të nderuar kolegë. Gjatë analizimit të kësaj rregulloreje dhe krahasimit të të dhënave në të, kam vërejtur disa mospërputhje brenda këtij dokumenti dhe në raport me statutin e komunës. Dallimet në emërtimet e drejtorive nga statuti i komunës në organigramin e administratës sipas saj rregullore janë: tri Drejtori ju shtohen të përbashkëta Drejtorisë së Administratës, Gjeodezi, Kadaster, Prona dhe të Shërbimeve Publike i shtohen edhe emergjenca. Tek kuvendi, në organogram është paraparë pos kryesuesit të kuvendit, sektori për punë të kuvendi dhe komitetet. Prandaj këto të dyja nuk janë të harmonizuara. Dy komitetet obligative që janë në organogram nuk janë në nenin shtatë të kësaj rregullore. Te Drejtoria për Kulturë, Rrini dhe Sport, pika tetë pikë në pikë në, Njësia e Shërbimeve, bibliotekist, numri i punëtorëve pesë. Për mua ky numër është i ekzagjërues kur dihet fakti se sa qytetarë frekuentojnë këtë bibliotekë. Kërkoj shpjegim nga eksperti. Unë ju kam referuar ekspertit që o pagu tetë mijë e pesëqind. Kërkoj falje se ti... Nuk je ti eksperti te pakten me letra. Se si ka paraparë aj këto pesë vende pune në bibliotekë? Te Drejtoria për Shërbime Publike, në pikën dymbëdhjetë pikë në, Sektori për Menaxhimin e Mbeturisë, kjo pikë nuk është harmonizuar me organigramin e Administratës, sepse nuk figuron në të. Neni 9 i kësaj rregullore thotë, Kabineti kryetarit ç'ka bien dash me Nenin 62 të Statutit të Komunës, i cili thotë Zyra e Kryetarit të Komunës. Neni 57, Shtëpia e Komunitetit si njësi e shërbimeve publike, e gjeni në organigramin e Administratës në kuadër të Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Miqësisë Sociale, por nuk e gjeni të harmonizuar me neni 22 të kësaj drejtorie. Unë gjatë elaborimit të këtij materiali, e kam hasur në Drejtorinë e Arsimit qeta qe e potencut dhe qet kërkesën që o dal prej Drejtorisë Arsimit dhe m'ka bo shumë përshtypje se ku ka shku ky sektori i Financave në kuadër të Drejtorisë së Arsimit. Dhe, çka do të bëhet me, me zyrtarin financiar të kësaj drejtorie? Ju dhat shpjegimin, prandaj unë preferoj që ai zyrtar nashti edhe pse ne, ne e opozita nuk e kemi këtë kërkesën që e ka bo Drejtoria e Arsimit, nuk e di pse pozita po, ne jo. A din? Nuk osht mirë me na ndau kështu. Po! Hë, ok. Mirë. Atëherë, atëherë po vazhdojë tutje. Të nderuar koleg, unë mendoj se kjo rregullore, "Për organizimin e mbrendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës". Kryesues, a po mban qetësi apo e lo..

Hajdar Sutaj

Koleg, nëse ke mundësi vetem ta përfundon, zotëri Mon Selmanaj fjalën.

Mon Selmanaj

Unë mendoj se kjo rregullore, "Për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës" duhet të harmonizohet më plotësisht me ligjin përveq qeverisjen lokale edhe statutin e komunës si dy dokumente bazë, me cilat funksionon komuna. Në të kundërtën ky kuvend duhet të nis procedurat për ndryshimet statutare dhe përshtatjen e tyre me gjitha rregulloret dhe me këto për sistemin e vendeve të punës. Ju falemnderit që patët durim me më ndegjua. Domethën, domethën si përfundim, qëky, qëky material i juvi nuk është në harmoni krejt me statutin e komunës. Prandaj lshonja një sy zoti, zoti Enver Cacaj. Faleminderit.

Hajdar Sutaj

Mon faleminderit shumë! Mundesisht lëshone mikrofonin te Enveri?

Enver Cacaj

Mon Faleminderit, i vlerësoj rekomandimet tua. Sa i përket harmonizimit të Statutit të Komunës së Deçanit me rregulloren, ëh, nuk jemi ndesh me ni arsye. Kishim me qenë ndesh sikur Statuti të kish pas 8 drejtori ose 10 drejtori dhe në rregulloret ishin parapa 11 drejtori. Gjendja faktike është me arsye. Nëse e kemi Drejtoria për Administratë edhe kemi shtuar Drejtoria për Administratë dhe Shërbime të Përbashkëta, nuk është ndesh me Statutin, sepse është shtu sektori për Shërbimet e Përbashkëta, ku deri me tani pozita e Lektorit, ku deri me tani, pozita e Përkthyesit, Zyrëtarit të Pranimit të mallit dhe rojeve të objektit nuk e kanë pas ni mbikëqyrës ose ni shef ni sektori. Nuk kemi pas sektor, ku është dashte me raportu drejtë për drejt, në Drejtorinë për Administratë, gjithësisht të Drejtori. Sa i përket Drejturisë për Shërbime Publike, Drejtoria për Shërbime Publike deri me tani e kemi titullu Drejtoria për Shërbime publike, ku sektori për emergjenca gjithmonë ka qenë në kuadër të asaj drejtorie, po ma herët nuk u qujte drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencia, ku obligohem ligjërisht edhe titullimin Emergjencia. Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencia. Domethën Derisa nuk kem shtim të drejtorive, ndryshon ni fjali, nuk ndryshon komplet emërtimi i drejtorise. Nuk jemi në desh me statutin edhe nuk e kemi, të nevojshme me e qit për ndryshim plotësim të titullimi të drejtoreshave. Sa i përket pozitave të bibliotekës. Baca Mon i nderum, momentalisht i kemi pesë pozita që janë aktual në bibliotekë. Funksionon biblioteka në Isniq edhe funksionon biblioteka e qytetit Nalt. Ku më vite me vite me vite i kemi pesë punëtor të punesum në bibliotekë. Sa ka frekuentim ose nuk ka, është çështje tjetër e qytetarëve. Nuk jemim unë mendoj që kur njoni nuk mundet me akuzu njoni tjetër pse ska frekuentim qytetar pse është aj numri i punëtorëve. Për momentin, ma herët u kon i lejuem është leju, kemi vazhdu një gja të tillë nuk jemi veç na, po jon disa komuna, të kategoria, bibliotekistat edhe shtëpia për komunitete i takojn kategorisë së zyrtareve publike. Ku kategoria e zyrtarëve publik është qëllimi pse quhen, të cilet kanë drejtë për drejt kontakt me qytetarin që i ofron shërbim drejtpërdrejt. Përket, quhen kategori e zyrtarëve publik. Edhe arsimi edhe shëndetësia edhe bibliotekistat edhe shtëpia e komunitetit janë kategori e zyrtarëve publik ku kanë drejtëpërdrejtë direkt ose pala që ofron shërbim me zyrtarin. Kjo është ndarja e kategorive, shërbyesve civil edhe kategoria e zyrtarëve publik.

Hajdar Sutaj

Enver, faleminderit shumë. Nëse ki mundësi mi dëgju edhe dy kolegë, Yllarta Thaqi, Orges Tafilaj janë lajmëru për fjalë. Yllarta Thaqi fillimisht fjalën pastaj Orgesi.

Yllarta Thaqi

Faleminderit! E ngriti si shqetësim, zotëri Mon kërkesën. Kërkesën unë sot e kom marrë në hyrje sa i përket Drejtorise së Arsimit nga zyrtarja Gjylshahe Haklaj, për shqetësimin e saj lidhur me pozitën e saj të punës. Ndërsa u referova për me marr përgjigje pak më drejtë për drejtë se edhe unë e kom lexu katalogin e vendeve të punës të Drejtoria e Arsimit. Më doket se është shtu ni zyrtar i lartë për arsim parashkollor. Atëherë nëse kanë mbi 500 punëtorë Drejtoria e Arsimit, a nuk mundet me qëndru edhe Zyra e Financave në të njëjtën drejtori sikur ka qëndru prej vitit 2000 e para, edhe e dyta, më gezon fakti se Zyra për Informim se ishte shut numri i punëtorëve. Kaq kam. Faleminderit shumë!

Hajdar Sutaj

Faleminderit, Yllartë! Orges Tafilaj fjalën, pastaj, Orges vazhdo tlutna, nëse keni mundësi pak vëmendje.

Orges Tafilaj

Faleminderit, kryesues. Realisht unë e kisha vetem një çështje. Ne kemi angazhu një ekspert për hartimin e kësaj rregullore. Me gjithë angazhimin e tij ne kemi shumë pikëpyetje lidhur me rregulloren siq kishim edhe si draft fillimisht. Madje na u desht që të marrim rekomandime nga Dyka, nga kryesuesi, nga njerëz tjerë, cili ka qenë realisht pastaj funksioni i këtij, i këtij eksperti. Ndoshta ka qenë më mirë që si edhe për rregulloret tjera, të themelohet Komisioni i Pushtetit sëbashku me Asamblen për një gjë të tillë. Përderisa edhe komunat tjera kanë pasur rregullore, besoj që një shembull ke mujt me marrë edhe nga komunat tjera. Dhe personalisht e konsideroj që angazhimi i këtij eksperti, megjithë problemet që ndodhën, megjithë polemikat që po hasen, besoj që ka qenë i panevojshëm. Faleminderit!

Hajdar Sutaj

Orges Faleminderit, Enver Cacaj e ka fjalën prap.

Enver Cacaj

Sa i përket pyetjes së Yllartës. Sa i përket kërkesës nga e nderuara Gjylshahi, kjo kërkesë që është ardhë te ju, unë nuk kam kërkesë, Gjylshahit ate dite në debatin publik ja kom spjegu kur e kemi mbajte debatin publik se pozita e Gjylshahit kalon në Drejtësinë për Buxhet dhe Financa. Nuk jetë papunë asnjë punëtor. Pse eshte bo kjo kerkese ne kuvend, e protokollume kujt ju ka dërgu? Po. Unë zyrtarisht s'e kam. Unë zyrtarisht s'e kam. Unë zyrtarisht unë zyrtarisht s'e kam. Atë ditë në takimin zyrtar, në takimin që ke pas për rekomandime, jom mundu te pakten me ju spjegu, unë zyrtarisht nuk u kom ate shkresë. Unë e spjegova, Gjylshah ta kom spjegu edhe ate dite përshkrimi detyrave osht për cdo pozitë, përshkrim detyrave nuk ka pozitë punës që nuk e ka përshkrimin dhe detyra edhe përgjegjesite edhe në leximin e parë kur e kemi lexuar kom thonë të gjitha konkurset që janë ndal asnjë konkurs nuk mundet me u publikuar pa përshkrim te detyra e punës, nëse ni zyrtar thojmë ku e kom përshkrimin e detyrave te punës ose nuk e dimë cilat përshkrime detyra e punës, unë nuk kam koment më tepër. Orges sa i përket pyetjes, sa i përket angazhimit të ekspertit ose mangësitë ose përparësitë e rregullores. Unë mendoj që është një situacion dikun kredibil e ka liçensu qatë person që ne kemi angazhuar. Jemi komuna e tetë që është e hartuar rregullorja me ekspert. Jo pse as na nuk kemi pasur. Jo pse nuk kemi kapacitete humanë ose njerëzore për me hartu nje rregullore. Po, po është pak problem kur po janë grupe punuese me hartu rregullore ose draft, sepse gjithmonë po bjen barra e përgjithësisë ni ose dy personave. Eksperti u kon ne takim edhe te kryetari i komunës. I kemi diskutu çështjet sipas katalogut vendeve punes sa mundem qysh mundem me i sistemu pozitat aktuale që janë. Unë mendoj që edhe me vite e me vite, nëse lojmë rregullorën, çdo njon me dhon komente ose rekomandime sipas dëshirës. Qysh neve na kon konvenon. Mendoj që kurrë një dokument, jo kjo rregullore po asnjë nuk ka mu përfund. Nganjëherë kur është interes i përgjithshëm...

Hajdar Sutaj

Enver Faleminderit shumë edhe Lutrim Haderxhonaj e ka një fjalë, edhe edhe nese mundemi me shku tu e permbyllë.

Leutrim Haderxhonaj

Përsëndetje Enver, përsëndetje për te gjithë. Pak ma konkret me kon se i ram rrotull e këtu krejt bisedum per ni pozitë te ni zyrëtares, zonjes në fjalë. Po m'duket osht tu i interesu a ka me punu prap qet

punë që ka mi bo edhe nëse shkon ne drejtorit tjetër edhe a ko mi bo veç për punë të arsimit apo kanë me ju shtu edhe punët e financave tjera. Bjeri ma trup se per qetu është krejt qëllimi, mos te hupim kohë.

Hajda Sutaj

Enver Cacaj fjalën prapë.

Enver Cacaj

Gjylshah ta kom spjegu, prap po ta potencoj kur bohet, veç një sekondë, prap pe potencojnë, janë disa pozita që ndryshojnë drejtorit ose pozitë e punës, munden nashti ni punë, një detyrë ma te vogël me pas ma shumë ose ma pak, ka me kon zyrtare per buxhet e financa ne kuader te arsimit ka mi kry punët e arsimit qysh i ka kryer deri tash. Gjyshaja a je e knaqur.

Hajdar Sutaj

Kështu, mfalni, mfalni se nuk guxojme me rënë në këtë debat kështu. Me çdo respekt, domethënë e tha edhe Orgesi, po mirë që është bo rregullorja, mirë që ka pasur debat publik, mirë që ka pasur rekomandime, mirë që po finalizohet. Drejtoresha Dafina Cacaj ka diçka fjalën edhe mandej e qesim ne votim. Drejtoreshë.

Dafina Cacaj

Kam çështjen ne lidhje me pozitën e Gjylshahit. S'po di përnime, Gjylshahi ska pasur nevojë as me pru kërkesën nëse e ndërron drejtorinë, nuk do me thonë që je ka del prej objektit. Kryetar, po du me thanë që përshkrimi i detyrave te punës nëse ti e ndërron një drejtori, na jemi kolegë edhe nëse ki me e ndërru drejtorinë duhet me i diskutu bashkë, skem nevoje me ardhë deri këtu, duhet bashkë me u diskutu do sene, edhe na, përshkrimin e detyrave normal që ka me bo apet njejtin se zyrtari për financa, duhet me kon në kuader për punët e drejtorisë së arsimit.

Hajdar Sutaj

Kështu veç me pak fjalë edhe po e kryejme. Ke mujt me u keqkuptu. Drejtorja e Arsimit ka pasë një kërkesë, nuk e ka pasë veç për zyrtarët financiarë, e ka pasë edhe për zyrtarë ligjorë dhe për një zyrtar tjetër që per momentin spo me kujtohet. Besoj që ato rekomandime ata eshte dasht me i dergu dhe tek kryetari edhe te Enveri që mi diskutu.

Ok, mirë është qe eshte ardhë puna vetem te nje qashtje e vogel. Na poashtu e kemi pasur një dakordim me Enverin që, te asistenti administrativ profesional tre me kalu dy, ndërsa profesional dy me kalu ni, edhe me qdo ndryshim me kisha qitur në votim, kete draft rregullor që me u shendrru në rregullore. Kush është për? A ka kundër? A ka abstenim? Vetem ti njeji. Një, dy, tre, katër, pesë, gjashtë, shtatë, tetë, nentë, dhjetë, njëmbëdhjete, dymbëdhjete, trembëdhjete, katermbëdhjete. Me pesëmbëdhjete, qysh ke votu, me gjashtëmbëdhjete vota për, me dy vota abstenim, asnje kunder. Kuvendi Komunal e ka miratue draft rregullorën për sistematizimin dhe organizimin e brendshëm të komunës. Z. Enver Cacaj, falemnderit edhe pergezime për punën, pune te mbare. Urime! Jemi te pika tete, shqyrtimi edhe miratimi i planit ndërkomunal për menaxhimin integruar të mbeturinave për pesë komunat e rajonit Dukagjinit, Pejë, Klinë, Istog, Deçan dhe Junik.

E kisha lute që drejtori për sherbime publike, Z. Izet Zenuni, me e marrë fjalën. Drejtor, fjala për juve.

Izet Zenuni

Falemnderit, kryesues! Draft rregullorja ka qenë edhe seancën e kalume, që është, ka kalu lexim te pare, ju ka nenshtruar debatit publik, do te thotë, nuk ka pasur ndonjë ndryshim esencial, e njoftimin jav kom dërgue për arsyet që me e pasë në seancë. Ju kisha lute me votu edhe me përfundu si dokument përfundimtar me e marrë.

Hajdar Sutaj

Drejtor, na të përgëzojmë për punën që e keni bo. A keni pak mundesi veç ta përfundojmë. Jemi duke e diskutu pikën e tetë, qe eshte shqyrtimi dhe miratimi i planit ndërkomunal menaxhimit të integruar mbeturinave për pesë komunat e rrafshit te Dukagjinit. E kemi diskutu mbledhjen e kalume eshte mbajte degjimi publik. Drejtori na ka spjegu detajisht se ky është i njëjti plan që është për Kline, Istog, Pejë, Deçan dhe Junik. Ju kisha lute me e qite ne votim, kush është për? A ka kundër? A ka abstenim? Konstatoj se ne menyre unanime, Kuvendi Komunal e ka miratue planin ndërkomunal për menaxhimin e mbeturinave. Jemi te pika nëntë, marrja e vendimit për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej tridhjetë mijë euro, për memorandumin e mirëkuptimit ndërmjet Komunës së Deçanit dhe ndërmarrjes publike lokale Hixhena dhe Fondacionit SNVP për instalimin e sistemit të ngrohjes qendrore ne bazë të biomasës. E kisha lënë kush do me marrë fjalën për këtë pikë. Komiteti për Politikë e Financa i ka jep mbeshtetje. Urdheroni, e ka fjalën Orgesi, pastaj Vatani.

Orges Tafilaj

Faleminderit, kryesues, pershendetje për te gjithë edhe njëherë! Meqënëse datat e nënshkrimit të marrëveshjes janë me 29 prill, pse eshte dashur te pritet që deri tash me ardhe kjo marreveshje ketu. Edhe kur jemi te kryeshefi ekzekutiv që është nënshkruar nga Kushtërimi, atëherë a ka dhene doreheqje kryeshefi, apo e ka lirë detyrën? Falemnderit!

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë, Vatan Istrefaj. Enver faleminderit shume, suksese punë te mbarë, urime.

Vatan Istrefaj

Faleminderit për fjalën, kryesues. Siç e ceke edhe ti, ne kemi diskutuar edhe në komitet këtë pikë. Pra bëhet fjalë për një vlerë prej tridhjetë mijë euro të cilen duhet ta ndajë Hixhena me memorandum bashkëpunimi me Fondacionin SNVP. Por, kryesues, ne të gjithë e dimë se komuna dhe Hixhena nuk janë në kohën më të mirë financiare për ti ndarë tridhjetë mijë euro për këtë pjesë, pasi që marrëveshja ka qenë në muajin një katërt. Personalisht kam disa vërejtje, sepse me tridhjetë mijë euro, nëse marrim shembull, Hixhena ngrohet me, me rrymë, për shembull, për momentin. Me tridhjetë mijë euro, për dhjetë vjet mundet mi kalu. Besoj që më e arsyeshme do te ishte qe këto para mu nda për veshmbathje dhe teshat e punëtorëve të operatives, të cilët kam hasur rastin t'i takoj dhe me një javë janë vetëm me një pale pantolla. Kurse nëse ne i ndajmë tridhjetë mijë euro për këtë pjesë, po mduket pak e kote. Faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shume. Mon Selmanaj e ka fjalën.

Mon Selmanaj

Faleminderit, kryesues. Të nderuar, me analizimin e këtij dokumenti apo të kësaj marrëveshje partneriteti për instalimin e ngrohjes qendrore në ndertesen e ndërmarrjes Hixhena dhe për shkrimin e kësaj marrëveshje përmes neneve të saj, na jep me kuptue që kryetari i komunës si nenshkruer i saj nuk i ka bere llogarit sa dhe si duhet. Në këtë marrëveshje mes 3 subjekteve na paraqiten qëllimi i marrëveshjes, përgjegjësite e palëve, financimi, obligimet e komunës, prokurimi, implementimi, etj. Tani këtu fillon loja. Kush e bëne pastrimin e pyjeve, bartjen, grumbullimin? Ose kush e bene tenderimin për pastrim të pyjeve? Cili është roli i komunës dhe NPL Hixhena në kete proces? Domethënë janë të pashpjeguara, të paqarta, për të cilat na deshirojmë të dijmë më shumë. Të nderuar koleg, në bazë ketyre pikëpyetjeve dhe dilemave që ngrita, për hir të korreksisë po jap disa alternativa ndryshe nga ky memorandum. Nen 1, nese keto mjetet ne shifer 70,000 euro NPL Hixhena do t'i shfrytëzonte per nxemje qendrore me pelet do t'i siguronte nxemjen për shtatëdhjetë vitet e ardhshme. Andaj, mendojeni mirë, duke ditur buxhetin e komunës dhe gjendjen në Hixhena, mendoj se do t'i thellonim edhe më shumë borxhet që i kanë. Ose komuna do të linte ndonje investim tjetër për të përmbushur këtë obligim të kësaj marrëveshje. Ju e dini, kolegë të nderuar që ne vitin e kaluar kemi marrë një vendim për ndarjen e pesëdhjetë mijë eurove për këtë ndërmarrje, vendim i cili nuk u implementua deri më sot. Paguani borxhet ndaj Hixhenes sepse eshte pranë falimentimit, së nëpër Facebook, ku mbet kryesuesi, se po i merr votat në shpinë të Hixhenes. Zoti kryesues... menoj qe edhe si alternativa tjera për ngrohjen qendrore mund t'i shfrytëzonin... pompat termike apo panelet solare. Nëse ky është si projekt ideor, si projekt... fillestar që për herë të parë po përdoret në komunën tonë me biomasë. Unë mendoj që e kemi shumë të paqartë na si Kuvend, se si po supozoj që kryhet ndërtimi i objektit, maqinëria... e gjitha ato... cili do të ishte hapi i radhës për sigurimin e pastrimit të pyjeve. Bartja e tyre, grumbullimi dhe kush do të hapte tender. Cila kompani do shkonte? A do të... a do ta kryente NPL Hixhena këto, do te thotë janë disa dilema për të cilat une nuk e kom një ide se si mund të vazhdohet.

Hajdar Sutaj

Mon nëse ki pak durim keto dilma ti hjek kryetari tani urdhëro kryetar Bashkim Ramosaj.

Bashkim Ramosaj

Faleminderit, ndoshta po filloj prej pyties që nuk është komplet tema, që u pytëm ose u interesum për... kryeshefin Ekzekutiv, kryeshefit i ka skadu mandati edhe po ashtu ka qenë qëllimi edhe i tij që mos me vazhdu më, ka pasur interes për një punë tjetër dhe në rregull nuk është ndonje telash ne kete far pjese ne me zor nuk mund ta ndalim askend, e dyta sa për atë që higjena po shkon drejt falimentimit kurr asnjeher per derisa un jam kryetar komune edhe per derisa un jam duke jetuar ne kete qytet edhe mos kofsha kryetar komune nuk ka me lan me falimentu, pertej qëllimit qe me perkufizu me nje fjal të urtë popullore ka thane nuk u lodha që mi hander ujku dhet por më erdh shumë mërzi kur e pashë bashk me ujqi duke e ngrene kopen e deleve në rast se më kuptove Mon fola edhe per llojin e atyre njerzve që janë brenda kësaj kompanie që nuk ja dojn të miren por kadal dal shkojn duke u sqaru keto tema po flas diqka per biomasen Mon se kamë besu dhe po besoj që e kemi diskutu edhe me shumicën me juve kur kemi ndejt së paku për kafe, ka qenë një koncept i zhvillum në vitin 2018 kur ne kemi qenë me një pjesë të zyrtarve të komunës ose me dy zyrtar të komunës në një visit studimore te higjenës që ka pasur të bej me biomasën me menagjimin e pyjeve dhe mbetjeve që kanë këto pyetje, është fakt që ka filluar si projekt ndoshta më shumë se 4 a 5 vjetë njëfar lloj lobimi dhe kemi ardhur këtë vitë ku kemi pasur nje dakordanc

ku unë e kam jape një pëlqim e që organizata (...) u mundu me kriju një buxhet I cili kish me na ndihmuar në këtë aspect dhe hapin e parë që e kemi bërë, po du me I ra shkurt pa ju marrurr shumë kohë, kemi folur për Gështënjën të gjitha subjektet politike te gjithë qytetarët e këtij vendi te gjith njerzit që janë eksperta të bujqësis, të pylltaris, që janë dashamirs te ambientit si me mbrojtë Gështënjenn që është diqka e qmueshme në komunën e Deçanit për atë kemi bër edhe një ditë tradicionale tashmë në Deçan që bëjmë një lloj falenderimi këtij lloj fruti që na ka mbajttë dikur ekonominë familjare dhe në këtë rast në këtë vitë në afatin e parë kur kemi filluar këto diskutime që është prilli ose që është më herët, ne kemi arritur me I pasë 20 hektar gështenjë të pastrume që është bërë pasrtimi I tyre ku ka ndodhur një diqka e mrekullushme sepse ti e ka pare gjënë e keqe dhe e ki pare gjënë positive gjënë e duhur, dhe ne kete rast ne na u ka krijuar një masë e konsiderushme e gatshme për biomasë e para është kjo, po ashtu kemi planifikuar që së paku deri më tani qa kemi planifikuar në buxhet në tubimet që I kemi pasur kemi thënë që prej 570 hektarëve gështenjë që I ka komplet komuna e Deçanit ne na duhet pjesë pjesë vitë pas viti me pastru këtë gështenjë e para është me I largu mbetjet që jan të pa nevojshme e dyta me I largu ato shkurre që pengojn gështenjën dhe ndikojn keq në shëndetin e tyre edhe e treta me mundur me ndergjegjësu që gështenja nuk pereht per hu teli nuk prehet për dru që me djeg por duhet me shërby si frut I cili është njëfar pasurie e këtij vendi dhe këto 570 hektar unë besoj që kan me I jape njëfar mase të konsiderushme për biomasë të njëjtën kohë ne kemi folur për 3 objekte ose 3 qendra kemi thënë po e bëjmë higjenën më së pari po e shikojm cili është efekti po bëjmë qendrën rinore kolonin e artistëve po e bëjmë fshatin turistik Shkëlzen Haradinaj dhe kemi pasur një interesim mi bë të gjitha institucionet publike qofshin shkolla, komuna, gjykata, policia e kështu me radhë dhe ka qenë po ashtu një ide e pakë njerëzve që kan synime më të mëdhaja që ndoshta me pas si gyp nëpër zonen urbane që ne mos me pasë nevoj ku fillon zona urbane ku perfundon mos me pas nevoj ngrohje tjetër po si llojë ngrohje e qytetit që përdorin e kan aplikuar shumë shtete para nesh, tjetra që është po e spjegoj konkretisht një rast ne kemi fituar kohën e fundit 570.000 euro një buxhet si raport I bashkpunimit ndërkufitar po ashtu presim me pasë një bashkpunim me 1 shtator ku ne e fitojm më shumë se 800.000 euro që kanë të bëjnë me ambientin qv po ashtu është bashkpunim ndërkufitar dhe tash I kemi 2 produkte turistike që është (...) (...) të cilat duhet mu pastru dhe kur ka mas aq shumë na kemi mundësi me ju dhënë qytetev të tjera besa edhe shtetev të tjera biomasë sa shkon dëm e kemi pasur një fatë të keq për shkak se fabrika që ka qenë e dedikume për biomasë me ardhë në Deçan nuk është vendosur në Deçan për shkak te kontesteve qe kemi pasur në atë kohë (....) edhe është vendosur diund tjetër, krejt e fundit po ashtu kjo asamble e ka miratuar një rregullore e cila ka te bëjë për shërbimet publike dhe është një taksë që krejt megjat vargësore që ne I kemi pronat tona mirpo që e pengojn rrugen komunale pronën komunale dhe pronën shtetërore publike ish dashtë me datë të caktume së paku 2 herë në vitë mi krosit këto në të kundërtën me I shku gjoba dhe kur krositen këto degë e këto rrema normal që shtrohet biomasë dhe po ashtu kemi shumë mbetje të lloqit të veqant që mundet me u përdor për biomasë andaj unë po besojë që duhet me provu, nuk janë në pyetje kostot është në pyetje efekti I mir menagjimit të një pasurie që është gështënja efekti I mir menagjimit të një pasurie që janë pyjet e Deçanit që nuk e ndalon ligji për pyjet nuk e ndalon as agjensioni I parkut dhe po besoj që ndodh diqka positive ju kisha ftuar ju kisha lutur me aprovu për shkak se nuk humbim asgjë faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë, po Mon urdhëro

Mon Selmanaj

Zt. Kryetar kur potencova falimentimin te kompanisë Higjienia mendova që vendimet nuk e elaborova ato që e thashë duke mos dashurë të marrë kohë mirpo tash po I ceki nja 2 a 3 arsye për të cilat më kanë shtyrë të mendoj ashtu mos implementimi I vendimit vitin e kaluar të asambles për 50.000 eurove qonë në atë drejtim, e dyta kohët e fundit I kemi atuomjetet e tyre për mbartjen e mbeturinave I kemi nëpër servise dhe kjo I pamundëson ose I detyron me marr hua mjete per mbledhjen e mbeturinave ne komuna

tjera, vonesa e pagave e tjera e tjera tv gjitha këto më bejnë të mendoj që kompania Higjiena nuk l ka punët mir ndërsa l zoti l saj nuk është ka l rrin gati me l kry obligimet ndaj sajë

Hajdar Sutaj

Mon kemi dalur jashtë teme

Mon Selmanaj

Jo nuk jemi dal, nuk jemi dal veç edhe...

Hajdar Sutaj

Na për marrëveshje jemi duke folur Mon sepse po flasim qdo muaj per higjinen

Mon Selmanaj

Veç edhe një fjal dashta kryetarit me ja thënë, sikurse ky nuk ka me lënë kompanin higjiena me falimentu aq në shumë kam dëshir që ajo me funksionu në mënyrën më të mirë të mundshme

Hajdar Sutaj

Unë e qes në votim kush është për këtë Marrëveshje?

A ka kundër?

A ka abstenim?

6 vota abstenim, 13 vota për, ka kaluar marrëveshja kalojmë në pikën 9 realisht të 10-të është formimi l komisionit për shpërndarjen e bursave për studentët dhe komisionit të ankesave procesit për ndarjen e bursave për studentet, të nderuar të pranishëm ashtu siq e dini edhe ju në bazë të rregullores që ne e kemi votuar dhe një pjesë e jona e kolegëve e kanë hartuar këtë rregullore komisioni do ti ketë 7 anëtar nëse keni mundësi vëmendje se është pika e fundit, janë 7 anëtar nga 7 anëtar 4 propozohen nga kuvendi e keni në material 1 nga shoqëria civile, 1 anëtar nga zyra e kryetarit dhe një nga drejtoria e arsimit që komandohet të jetë edhe udhëheqës në bazë të rregullores të komisionit pastaj bëhet komisioni nga 3 anëtar l ankesave 1 është nga DKA-ja edhe 2 nga kuvendi, urdhëro Orges

Orges Tafilaj

Faleminderit kryesus realisht para votimit të Komisionit e kisha vetëm një kërkesë për Drejtorin e Arsimit po me qenë se këta nuk janë këtu me siguri ju përcjellët, konkursi kur çitet, çitet në përputhje me rregullorin që e kemi hartu sepse herën e fundit ka pas telashe pikërisht për këtë domethanë kushti i parë është nota mesatare dhe gjysë note ose një note më pak nëse plotësohen kushtet e kategorive të caktume mos të vendosen pik të caktume, sepse pastaj po kanë telashe komisionin ne përzgjedhjen e saj.

Hajdar Sutaj

Komisioni ka të drejtë për me kriju rrethana lehtësuese po jo vështirësuese në këtë process e kështu prej 4 anëtarëve të kuvendit

Albesa Cacaj

Më kon kundërshtare e madhe e vendimit propozim vendimit që na ka ardhë nga Drejtoria për Arsim, ku nuk e ka inkorporuar një anëtar nga Drejtoria e Arsimit, ndërsa kësaj radhe qenka, lutja tjetër e dytë që kisha dasht me marrë shumë seriozisht është me sjell emra që vërtet din me bë dallimin edhe dinë me punu, po din me bo dallimin mes draftit edhe rregullores faleminderit.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë kështu 4 anëtarë nga Kuvendi 2 nga pozita, 2 nga opozita grupi I Aak-së kënd e propozon Arian Dobraj relisht edhe Yllarta Thaqi e ka kërkuar fjalën.

Yllarta Thaqi

Arian Dobraj dhe Elmedina Sadikaj.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë nga Ldk-ja, Vatan Istrefaj.

Vatan Istrefaj

Albesa Cacaj

Hajdar Sutaj

Vv-ja, Teuta Neziraj?

Komisioni poashtu nga zyra e kryetarit është propozuar Manjolla Shala ndërsa si udhëheqëse nga komisioni i drejtorisë për Arsim është caktu Violeta Kukalaj është propozuar, komisioni po ashtu duhet të jetë një nga shoqëria civile, po zotëri Mon Selmanaj urdhëro.

Mon Selmanaj

Falemnderit kryesus unë e propozoj zt. Adem Lushaj, është drejtues i shoqatës së intelektualëve të pavarur, besoj të gjithë e njihni ndoshta nuk është nevoja me prezantu.

Hajdar Sutaj

Po I mrekullueshëm.

Mon Selmanaj

Biografinë e tij me cek, punën e tij, angazhimin e tij edhe shkrimtar edhe matematikient edhe politikan.

Hajdar Sutaj

Faleminderit shumë mbi të gjitha neve na pëlqen si njeri për parimet që i ka edhe e rrespektojm shumë.

Mon Selmanaj

Është njeri me të gjitha të mirat për këtë process.

Hajdar Sutaj

Kështu 3 anëtarë të ankesave nga DKA-ja është propozur Zeq Malaj, pozita kënd e prozon Shkodran Mustafaj, Opozita ne rregull e qes në votim Zeq Malaj kështu komisioni vetëm nëse keni mundësi ta qesë në votim përbehet nga Violeta Kukalaj kryesuse, Arian Dobraj, Elmedian Sadikaj, Albesa Cacaj, Teuta Neziraj, Adem Lushaj dhe Manjolla Shalaj komisioni I ankesave perbehet nga Zeq Malaj, Shkodran Mustafaj dhe nga Blinera Lokaj.

Kush është për?

A ka kundër?

A ka Abstenim?

Konstatoj që e kemi votuar komisionin për bursa jemi tek pika e fundit tek të ndryshmet a ka dikush diqka, urdhëro Vatan Istrefaj

Vatan Istrefaj

Faleminderit kryesus, drejtor pasi që kryetari shkojë kontrata per mirëmbajten e rrugëve dhe rrugicave në komunën tonë, kryesus më fal a ka mundësi me na ndëgju edhe 1 minutë.

Kontrata për mirëmbajten e rrugëve ka skaduar drejtor po e dimë a ka mundësi që të hapet ndonje procedur e re për këtë kontrat apo qfarë pasi që si të themi rrugët janë bërë pa mirë mbajtje në gjendje të mjerushme nëpër fshatra edhe shpesh here veturat nuk po munden me kalu faleminderit.

Hajdar Sutaj

E kemi pasur të votuar te të ndryshmet që me shfuqizu vendimin numër 01 numër 2-2 të dates 28.03.2025 për ndarjen e parcellës për ndërtimin e njesive të reja banesore për banim social dhe banim të përballushëm me arsyetimin që Ministria pas shqyrtimit të vendimit të lartcekur ku konstatoj se vendimi duhet të jetë i bazuar në dokumente e planifikimit hapsinor sipas ligjit numër 04 / për (...) per planfikim hapsinor si dhe dokumentet e tjera që janë të parapara me këtë ligjë dhe të shikohet lokacioni i planfikuar sipas dokumenteve te planifikimit hapsinor në fuqi dhe e keni aryetimin e plotë nuk po e lexoj sepse e keni në material ju kisha lutur kush është për? Jo jo vetëm kemi me shfuqizu nuk kemi asnjë diskutim këtu. A ka kundër? A ka abstenim?

Konstatoj që kemi shfuqizuar edhe e kisha lutur Mon Selmanaj pikën tek të ndryshmet ta vazhdoj seancën se më duhet me lëvizë, urdhëro drejtori e ka fjalën.

Drejtori, Izet Zenuni

Meqenëse në muajin Maj ka skaduar e mirëmbajtjes ne jemi per lidhje te procedurav qoftë nevoja në teren për me fillu procedurat e tenderit besoj që javën tjetër fillon publikohet edhe afatet ligjor sa mundet me zgjatë.

Hajdar Sutaj

Kolegë me kaq e mbylli seancën mirë u takofshim në seancën e radhës.

